



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**Fjala e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Kuvend**

*E nderuar Zonja Kryetare e Kuvendit,*

*Të nderuar Zonja e Zotërinj Deputetë,*

Kam kënaqësinë të raportoj përpara Kuvendit, për veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2023 dhe t'ju informoj në lidhje me situatën e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, ç'ka është edhe një detyrim që e sanksionon ky ligj, si dhe për ecurinë e punëve të tjera të ngarkuara nga Kuvendi, nëpërmjet rezolutës së miratimit të veprimtarisë për vitin paraardhës.

Gjatë këtij viti, në zbatim të kompetencave ligjore, Komisioneri ka vijuar punën në drejtim të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, për të siguruar përmbushjen e qëllimit të ligjit, që është krijimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Me këtë synim, janë përfshirë në procesin e mbikëqyrjes të gjitha institutet e ligjit, por një fokus të veçantë ka pasur rekrutimi dhe disiplina në shërbimin civil, si dy aspekte që e tregojnë më së miri nivelin e zbatimit të ligjit. Aplikimi i këtyre dy instituteve të rëndësishme të ligjit në praktikë nga njëra anë po tregon arritje pozitive në drejtim të vendosjes së kornizave procedurale, por nga ana tjetër, aty shfaqen edhe sfidat më të vështira dhe nevoja për të ndërhyrë herë pas here, si me vendime paralajmëruese, ashtu edhe me udhëzime, asistencë teknike, apo evidentimin e nevojës për ndryshime ligjore.

Një arritje e rëndësishme në fushën e shërbimit civil, të cilën dëshiroj ta evidentoj që në fillim të fjalës sime, është aplikimi i pjesshëm i reformës së pagave në sistemin e shërbimit civil, nga e cila përfituan rritje page nëpunësit civilë në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, ç'ka tashmë e bën më atraktiv edhe punësimin në këto institucione. Sfida për më tej, është aplikimi i reformës së pagave edhe në administratën vendore, duke unifikuar në këtë mënyrë të gjithë sistemin e pagave në secilën tipologji të institucioneve të shërbimit civil. Në këtë mënyrë, do të krijohen kushtet për të ulur nivelin e emërimeve në kundërshtim me ligjin në ato njësi të vetëqeverisjes vendore, që kanë aplikuar emërimet e përkohshme, duke mos zhvilluar më parë procedurat e konkurrimit.

Nga njëra anë, në këtë fazë të zhvillimit të tij, procesi i administrimit të shërbimit civil është vendosur në korniza procedurale, pasi rregullohet nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore

që e shoqërojnë atë, por në praktikë, jo gjithmonë respektohen kërkesat e parashikuara në këtë bazë ligjore. Në këto rrethana, Komisioneri e ka orientuar punën e tij të përditshme, në rritjen e nivelit të zbatimit të ligjit, duke sjellë sa më pranë konceptet e tij me aplikimin e tyre në praktikë.

Bashkëpunimi me dy institucionet e rëndësishme që plotësojnë skemën e administrimit të shërbimit civil, që janë Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka vijuar të jetë në nivele shumë të mira, si në drejtim të zbatimit të ligjit, ashtu edhe gjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara në procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Nga Departamenti i Administratës Publike, Komisioneri ka kërkuar që të jetë më aktiv në drejtim të asistencës së institucioneve në të gjithë sistemin e shërbimit civil, ndërkohë që, nga Shkolla e Administratës Publike, është kërkuar rritja e nivelit të përgatitjes së nëpunësve civilë, pasqyruar në plotësimin e përmbajtjes së kurrikulave aktuale, si dhe në hartimin e kurrikulave të reja të trajnimit, që i përgjigjen kërkesave të kohës.

✦ Gjatë këtij viti ka vijuar puna e nisur në drejtim të **ndihmës së institucioneve të administratës vendore, për të përmirësuar organizimin e brendshëm të tyre** dhe për të sjellë në standardet ligjore strukturën organizative, sa i takon ndërtimit të sistemit të shërbimit civil. Ka vijuar punën grupi i specializuar në këtë drejtim dhe gjatë vitit 2023 mund të raportojmë se është rritur ndjeshëm numri i subjekteve të administratës vendore që aplikojnë modelet më të mira në këtë drejtim.

Në këtë aspekt është punuar sidomos në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, pas përmbjlljes së konstituimit të organeve të qeverisjes vendore që dolën nga zgjedhjet e organizuara këtë vit. Vijon të evidentohet një nivel i lartë bashkëpunimi ndërinstytucional me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Vlerësimet e Komisionerit në lidhje me situatën e evidentuar, janë mirëpritur prej tyre dhe rekomandimet përkatëse janë pasqyruar gjatë zhvillimit të procesit, sipas rastit.

✦ **Vendimet gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues**, kanë vijuar të jenë në vëmendjen e Komisionerit. Në vitin që po raportojmë, ky proces është orientuar në institucionet e administratës vendore. Në këtë proces janë administruar të dhëna nga **61 bashki dhe 12 këshilla qarku**, nga ku rezultuan se ishin **108** vendime gjyqësore të formës së prerë për ekzekutim, nga të cilat kanë mundur të ekzekutohen vetëm **13** prej tyre ose **12%** të rasteve, ndërsa janë ende të pa ekzekutuara **95** vendime, ose **88%** të rasteve, **për të cilët është realizuar regjistrimi në listë pritje i nëpunësve gjyqfitues.**

Po kështu, nëpërmjet grupit të punës të përbashkët që është ngritur, me pjesëmarrës edhe nga Departamenti i Administratës Publike, është punuar edhe në drejtim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në administratën shtetërore, për rastet që janë trajtuar nga institucionet nëpërmjet Komisioneve të Posaçme, gjatë këtij viti.

Të gjitha të dhënat e administruara dhe përfundimet e arritura, të pasqyruara në raportin e vlerësimit që është miratuar për këtë rast nga Komisioneri, i janë njoftuar institucioneve që mund të mbështesin administratën vendore për të rritur nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, ndër të cilat janë Ministria e Financave; Ministria për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore, etj.

✦ Për sa i përket aspektit të trajtimit të informacioneve, theksojmë se këtë vit janë administruar **117 informacione/kërkesa/sinjalizime** që kanë ardhur në drejtim të Komisionerit, për të cilat ka përfunduar shqyrtimi. Krahasuar me një vit më parë, numri ka qenë **në trend rritës**.

Edhe pse, Komisioneri nuk ka për kompetencë direkte zgjidhjen e ankesave të nëpunësve apo shtetasve të ndryshëm, bazuar në të drejtën e tij për të mbikëqyrur kryesisht, ose me kërkesë të institucioneve, administrimin e shërbimit civil, ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e gjithë informacioneve/kërkesave apo denoncimeve të ndryshme, të ardhura në adresë të tij, duke i dhënë përgjigje konkrete shqetësimeve të ngritura nga subjektet e ligjit si edhe qytetarët, apo nëpërmjet vendimeve paralajmëruese për rregullimin e situatës ligjore, në rastet kur ka konstatuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit.

✦ **Procesi i mbikëqyrjes së planifikuar** është shtrirë në **16** institucione, ku përfshihen të gjitha tipologjitë e tyre, të administratës shtetërore, vendore dhe institucione të pavarura.

Gjatë këtij procesi janë verifikuar **1422** pozicione të shërbimit civil, dhe nisur nga mënyra e plotësimit të tyre, ka rezultuar se, **219** pozicione ose rreth **15%** e numrit të përgjithshëm, **janë vende të lira; 1173** pozicione ose rreth **83%**, janë të zëna në përputhje me ligjin dhe **30** pozicione ose rreth **2%**, janë të zëna nga punonjës të emëruar me akte në kundërshtim me ligjin (*duke përfshirë në këtë shifër situatën në të gjithë tipologjitë e institucioneve të mbikëqyrura*).

○ Në **institucionet e administratës vendore**, edhe gjatë këtij viti është orientuar procesi në drejtim të procedurave të rekrutimit në kategorinë e bashkive. Vijon të mbetet problem fenomeni i emërimeve në kundërshtim me ligjin, duke mos kryer më parë procesin e konkurrimit.

Në fakt, emërimet në kundërshtim me ligjin gjatë këtij viti, në procesin e mbikëqyrjes së planifikuar, janë konstatuar vetëm në administratën vendore, ku nga **414** pozicione të mbikëqyrura, **30** janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, ose **8 %** e të gjithë pozicioneve të shërbimit civil të kontrolluara.

Ndërkohë, nga procesi i monitorimit të administrimit të shërbimit civil, që Komisioneri zhvillon përgjatë gjithë vitit kalendarik, nëpërmjet raportimit periodik të institucioneve të administratës vendore, rezulton se numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës, të plotësuar në kundërshtim me ligjin për vitin 2023 është **945** (ose **14%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbim civil). Kjo situatë problematike justifikohet nga institucionet sidomos me mungesën e interesit për shkak

të pagave të ulëta, si edhe me mungesën e kandidatëve të kualifikuar për pozicionet e shpallura në këto njësi.

Në fakt, rënia e interesit për të konkurruar është evidentuar edhe gjatë mbikëqyrjeve të zhvilluara nga Komisioneri, pasi rezulton që vendet e lira publikohen për t'u plotësuar, por procesi dështon në mbi 50% të rasteve, për mungesë të paraqitjes së kandidaturave për të marrë pjesë në konkurrim, ose paraqitjen e kandidatëve që nuk i përmbushin kriteret e përgjithshme, apo të veçanta për pozicionin e punës.

- Në **institucionet e pavarura** mbikëqyrja ka qenë e përgjithshme ose e orientuar kryesisht në zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Ka rezultuar se, në këtë tipologji institucionesh, në përgjithësi ligji kuptohet dhe zbatohet drejt.
- Në **institucionet e administratës shtetërore**, ka vijuar të orientohet procesi kryesisht në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit të performancës në punë të nëpunësit civil edhe në ministritë që nuk u mbikëqyrën një vit më parë, duke e përmbyllur kështu procesin në këtë tipologji institucionesh, ndërkohë që procesi i rekrutimit në administratën shtetërore është ndjekur në vijimësi nëpërmjet mbikëqyrjes së zhvilluar pranë Departamentit të Administratës Publike.

Në këto institucione, janë konstatuar pothuajse të njëjtat probleme të evidentuara në subjektet e kontrolluara më parë, të cilat shfaqen kryesisht në faktin se procesi i vlerësimit të punës paraqet mangësi të theksuara, sidomos në përmbajtje, pasi formalisht, është realizuar si proces. Formulari i vlerësimit nuk plotësohet sipas kërkesave të ligjit në rubrikat përkatëse, e për këtë arsye cedon në drejtim të objektivitetit të vlerësimit. Nëpunësit civilë të ngarkuar me këtë proces kanë mangësi në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të ligjit dhe ky proces aktualisht po shkon drejt formalizimit, që nënkupton thjesht vendosjen e disa notave në formular, pa komentet përkatëse. I kryer në këtë mënyrë, procesi lejon mundësinë e humbjes së interesit dhe motivimit të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie, në kushtet kur vlerësimin "*shumë mirë*" dhe "*mirë*" e marrin pothuajse të gjithë nëpunësit civilë në institucion.

Në këtë situatë, Komisioneri vlerëson se zgjidhja e problemit është futja e procesit të vlerësimit në rrugë procedurale dhe sidomos trajnimi i zyrtarëve vlerësues me qëllim që të rritet objektiviteti në veprimet e tyre dhe të vlerësohet secili nëpunës në bazë të meritës dhe profesionalizimit të treguar gjatë realizimit të detyrave. Po kështu, për përmirësimin e situatës, në vijim do të ndikojnë edhe përmirësimet ligjore, të cilat tashmë janë propozuar dhe ende nuk kanë ndodhur, ku parashikohet ndër të tjera, edhe zgjerimi i spektrit të vlerësimit, nëpërmjet shtimit të niveleve me më shumë se 4, që aplikohen aktualisht dhe njëkohësisht e lidhin procesin edhe me një motivim konkret, që ndikon në rritjen e hapave të pagës, çka aktualisht nuk është e parashikuar në ligj.

- ✦ Si një detyrë, që tashmë kryhet në çdo proces zgjedhor, ka vijuar mbikëqyrja e administrimit të shërbimit civil dhe **monitorimi i sjelljes së nëpunësit civil** në kushtet e zgjedhjeve për organet drejtuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Procesi i monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil përgjatë fushatës elektorale ka nisur me Urdhrin e Brendshëm nr. 15 (128 prot.), datë 3.2.2023, “*Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie: emërimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor*”, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në detyrat e ngarkuara për vitin 2023 nga Kuvendi, në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit.

Në këtë proces, janë vendosur kontaktet me **205** institucione të administratës publike dhe janë përfshirë **13425** pozicione pune pjesë e shërbimit civil. Gjatë këtij procesi janë ngritur **205** Grupe Monitorimi, të cilët, në mënyrë korrekte, kanë komunikuar në vijimësi, gjatë gjithë periudhës zgjedhore, me Komisionerin.

Me qëllim zbatimin e drejtë dhe të unifikuar në praktikë të ligjit, gjatë kësaj periudhe zgjedhore, i është paraprirë procesit nëpërmjet Udhëzuesit nr. 11 (144 prot.), datë 10.2.2023, të Komisionerit, “*Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me “Platformat” apo “Rrjetet sociale” që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën*”, në përmbajtjen e të cilit janë sqaruar dhe orientuar institucionet që përfshihen në sistemin e shërbimit civil, për mënyrën se si duhet të veprojnë për çdo rast, kur kanë paqartësi.

Duhet të theksojmë se nëpërmjet udhëzuesit në fjalë, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet e shërbimit civil që për një periudhë kohore të përcaktuar (*nga data 1.3.2023 deri në datën 13.5.2023*) **të pezullohet procesi për të nisur procedura të reja rekrutimi** në të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil, me qëllim që të parandalohet mundësia për t’u përdorur si një mjet për të ndikuar negativisht në procesin zgjedhor. Ky udhëzim i Komisionerit **është zbatuar në mënyrë unanime nga të gjitha institucionet, pa asnjë kontestim.**

Referuar këtij udhëzuesi, në rastet kur institucionet kanë vlerësuar se ndodhen në kushtet kur janë paraqitur nevoja të përligjura për të plotësuar pozicionet e punës dhe me qëllim që të mos pengohet veprimtaria e institucionit, i janë drejtuar Komisionerit (*bëhet fjalë për 8 institucione, kryesisht në tipologjinë e institucioneve të pavarura, KLP dhe AMA*), duke kërkuar të vlerësohet mundësia për shpalljen e **25** pozicioneve vakante, (*nga të cilat rezulton se është miratuar kërkesa për 22 pozicione pune dhe është refuzuar kërkesa për 3 pozicione*).

Vlen të evidentohet fakti se institucionet të cilave i është drejtuar udhëzuesi, i janë përmbajtur dhe e kanë zbatuar atë në mënyrë korrekte, duke kërkuar miratimin paraprak të Komisionerit, përpara fillimit të procedurave, të diktura nga nevojat imediate të institucionit.

- Gjatë periudhës zgjedhore rezultoi se janë evidentuar **22** raste emërimesh në pozicione të shërbimit civil, ku **11** raste, i përkasin institucioneve të pavarura, **8** raste institucioneve të administratës shtetërore dhe **3** raste institucioneve të vetëqeverisjes vendore.  
Në të gjitha rastet e emërimeve në pozicione të shërbimit civil, përveç 1 rasti që i përket institucioneve të vetëqeverisjes vendore (*Bashki*), procesi është zhvilluar në përputhje me ligjin.
- Referuar të dhënave të administruara gjatë këtij procesi, rezultojnë **30** raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil **nëpërmjet dorëheqjes** nga detyra, nga të cilat **5** raste, i përkasin institucioneve të pavarura; **8** raste, institucioneve të administratës shtetërore dhe **17** raste, njësive të qeverisjes vendore.
- Gjatë kësaj periudhe, rezultoi se **kanë pezulluar** marrëdhënien në shërbimin civil, **27** nëpunës civilë, nga të cilët, **2** raste i përkasin institucioneve të pavarura; **7** raste administratës shtetërore dhe **18** raste njësive të qeverisjes vendore. Kërkesa për pezullim në **8** raste nuk ka lidhje me procesin zgjedhor, ndërsa në **19** raste, asyeja e kërkesës për pezullim lidhet me pjesëmarrjen e nëpunësve si kandidatë për t'u zgjedhur në organet vendore.
- Për të gjithë periudhën zgjedhore ka pasur **7** raste të lirimit nga shërbimi civil, për shkak të mbushjes së moshës **për daljen në pension të plotë pleqërie**, nga të cilat **1** rast i përket institucioneve të pavarura; **5** raste institucioneve të administratës shtetërore dhe **1** rast, institucioneve të qeverisjes vendore.
- Një rëndësi të veçantë Komisioneri i ka kushtuar edhe **verifikimit të informacioneve** lidhur me pretendime për parregullsi në sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor.

Në postën elektronike të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka ardhur informacioni "*Denoncim*", për 21 punonjës të **Bashkisë Cërrik**, për pjesëmarrje në një takim elektoral, gjatë vizitës së Kryeministrit të Shqipërisë në këtë qytet, në datën 1.5.2023.

Në lidhje me situatën e krijuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet postës elektronike, e-mail të datës 8.5.2023, ka kërkuar verifikimin e rastit nga ana e burimeve njerëzore të kësaj bashkie.

Në vijim të komunikimit, me e-mail të datës 9.5.2023, Bashkia Cërrik ka njoftuar Komisionerin se, nga 21 punonjës të denoncuar, 17 prej tyre janë nëpunës civilë, ndërsa në 4 raste bëhet fjalë për punonjës të emëruar në pozicione pune jashtë shërbimi civil.

Pas hetimit administrativ të rastit të mësipërm, rezultoi se kjo veprimtari politike është zhvilluar në datën 1.5.2023, që ishte ditë pushimi zyrtar dhe për këtë arsye nuk u evidentua asnjë shkelje që

vërteton sjelljen e nëpunësve civilë, që vijnë në kundërshtim me pikën 1, të nenit 37, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku citohet se: “Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar dhe nuk duhet të shprehë hapur bindjet apo preferencat e tij politike”. Për këtë arsye, hetimi administrativ në lidhje me rastin në fjalë nuk u vijua më tej.

Komisioneri vlerëson se tashmë është krijuar një praktikë e mirë pune në realizimin e procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë, ç’ka u evidentua si në këtë proces zgjedhor, ashtu edhe në periudhat e mëparshme. Shërbimi civil ka vijuar të tregojë maturi në drejtim të zbatimit të parimit të paanësisë politike, duke ndikuar pozitivisht për krijimin e një klime normale zgjedhore, pa probleme, e po kështu duke i ardhur në ndihmë edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në rolin e anëtarëve të strukturave të posaçme të ngritura për të realizuar procesin zgjedhor.

- ✦ Është kryer edhe këtë vit, procesi i mbikëqyrjes së orientuar drejt **monitorimit "online" dhe në subjekt, në lidhje me rekrutimet** e realizuara nga Departamenti i Administratës Publike.

Ky proces është realizuar pranë DAP, për **1158** pozicione pune, duke monitoruar **700** procedura konkurrimi “online”, nëpërmjet sistemit që aplikon DAP, për konkurrimet, **549** nga të cilat kanë përfunduar nëpërmjet publikimit të njoftimit të fituesit (*deri në fund të muajit Dhjetor 2023*) dhe **151** procedura konkurrimi rezultojnë të jenë shpallur në fund të vitit 2023, e për këtë arsye janë raportuar ende në proces, në raportin vjetor. Grupi i posaçëm e ka ndjekur procesin nëpërmjet monitorimit “online” në kohë reale, të shpalljeve publike në portalin e rekrutimit, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me punonjësit e Departamentit të Administratës Publike të ngarkuar me aplikimin e procesit të rekrutimit të burimeve njerëzore në administratën shtetërore.

Në kuadër të mbikëqyrjes së administrimit të procesit të konkurremeve, Komisioneri ka trajtuar dhe **13** informacione të ardhura në adresë të tij, nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit. Janë përfshirë në proces të thelluar administrativ të gjitha procedurat e konkurrimit për të cilat ka pasur indicie për parregullsi të procesit dhe në përgjithësi, ka rezultuar se Departamenti i Administratës Publike ka vepruar në përputhje me procedurat ligjore.

Megjithatë, edhe gjatë këtij viti, Komisioneri e ka konstatuar nevojën që ka DAP dhe aktorët e tjerë të procesit, të përfshirë në realizimin e konkurremeve, për të përmirësuar punën, fillimisht në drejtim të evidentimit të pozicioneve të lira në planin vjetor të rekrutimit, dhe më tej në procedurat e konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv, në përputhje me parimet e përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, duke i ndërtuar me efikasitet grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim realizimin e një gare të ndershme, garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë, si dhe kryerjen në mënyrë sa më efektive të procedurave të rekrutimit.

- ✦ Ka vijuar edhe këtë vit, mbikëqyrja e orientuar në lidhje me **monitorimin e procesit të lirimit nga shërbimi civil të punonjësve që kanë plotësuar moshën** për të dalë në pension të plotë pleqërie.

Komisioneri, e ka nisur me një vendim këtë proces duke kërkuar informacion nga **178** institucione të administratës publike pjesë e shërbimit civil. Nga verifikimi i informacionit të dërguar ka rezultuar se deri në dhjetor 2023, kanë plotësuar moshën për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë **275** nëpunës civilë, nga të cilët **50** raste janë mbartur nga viti 2022 dhe **225** raste, i përkasin viti 2023.

Në përfundim të këtij procesi, institucionet kanë përfunduar marrëdhënien e shërbimit civil me **177** nëpunës civilë që kanë plotësuar moshën për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë, ndërkohë janë në proces rastet e tjera.

- ✦ Gjatë këtij viti, është vlerësuar situata në lidhje me **vendet e paplotësuara** në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në administratën publike, ç`ka në fakt është një problem që është shfaqur disa vite më parë, gjatë mbikëqyrjes së procesit të plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Nëpërmjet një vendimi, Komisioneri, ka filluar mbikëqyrjen e orientuar në lidhje me vendet e paplotësuara në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në të gjithë sistemin e shërbimit civil dhe ka komunikuar me **187** institucione, për të administruar informacionin e nevojshëm. Sipas të dhënave të raportuara, rezulton se, në të gjithë sistemin e shërbimit civil **17.1%** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil janë pozicione vakante në kuptim të ligjit, nga të cilat **10.4%** në administratën shtetërore, **5.9%** në njësitë e qeverisjes vendore dhe **0.8%** në institucionet e pavarura. Nga **15230** pozicione pune pjesë e shërbimit civil të raportuara nga institucionet e administratës publike, referuar strukturave të tyre rezulton se **2613** pozicione pune janë të paplotësuara ose të plotësuara në kundërshtim me ligjin.

Në fakt kjo është situata e evidentuar, por duhet të sjellim në vëmendjen tuaj se në këtë moment është duke u punuar nga të gjitha institucionet, për të përshtatur strukturat dhe për të përcaktuar me saktësi numrin e pozicioneve të nevojshme në raport me veprimtarinë e institucionit, ç`ka po realizohet në procesin e ristrukturimit, ku aktualisht është e përfshirë pothuajse e gjithë administrata shtetërore. Po kështu, edhe institucionet e administratës vendore, po punojnë në këtë drejtim në kuadër të rivlerësimit të pozicioneve të punës në sistemin e shërbimit civil dhe riorganizimit të strukturave të tyre, për t`u përshtatur me ndryshimet në nivelin e pagave.

Vlerësojmë se këto procese do të sjellin përfundimisht një numër të pozicioneve të punës më pranë nevojave të institucioneve për të realizuar detyrat e tyre e për pasojë do të ulët ndjeshëm edhe numri i pozicioneve të paplotësuara.

- ✦ **Zbatimi i vendimeve paralajmëruese**, për rregullimin e situatës ligjore, pas përfundimit



të afatit të paralajmërimit, është gjithmonë në qendër të vëmendjes së Komisionerit.

Për periudhën që po raportohet, procesi i verifikimit të zbatimit të tyre nga institucionet është realizuar për **47** vendime paralajmëruese të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, inspektimit apo hetimit administrativ. Në përfundim të verifikimit, rezulton se procesi ka përfunduar brenda vitit për **83%** të vendimeve dhe **17%** e tyre janë mbartur për vitin pasardhës. Ndërkohë në vitin 2022 procesi i verifikimit ka përfunduar brenda vitit, në **54%** të rasteve, në **19%** të rasteve procesi është pezulluar dhe janë mbartur për vitin pasardhës **27%** e vendimeve.

Pra, sikundër vërehet, në vitin 2023, procesi i verifikimit të zbatimit të vendimeve të Komisionerit ka ndjekur një trend pozitiv, duke pësuar një rritje me **29%**.

Nisur nga përpjekjet serioze të institucioneve të mbikëqyrura për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në përputhje me detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimet paralajmëruese, *nuk ka qenë e nevojshme të aplikohen masa detyruese për gjëmbajtjen e nëpunësve* që administrojnë shërbimin civil.

- † **Ndjekja e proceseve gjyqësore**, në rastet kur Komisioneri është thirrur nga gjykata, si palë në pozita të ndryshme procedurale, është një detyrë e vazhdueshme që ndiqet gjatë gjithë vitit nga stafi i Komisionerit.

Komisioneri ka marrë pjesë në gjykimet e zhvilluara pranë Gjykatave Administrative për **64** procese administrative, e cila është një shifër në trend rritës, krahasuar me një vit më parë, ku kanë qenë **54** procese të ndjekura, dhe rekomandimet e Komisionerit, apo parashtrimet e bëra prej tij përpara gjykatës kanë vijuar të vlerësohen të drejta dhe janë marrë në konsideratë nga këto të fundit, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

- † **Detyrat e rezolutës** së Kuvendit janë mbajtur në vëmendje të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht.

Në kuadër të rezolutës së Kuvendit për vitin 2023, na janë lënë disa detyra që kanë lidhje me procesin e evidentimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqësorë; verifikimin e ecurisë së procesit të popullimit me të dhëna të sistemeve: Regjistri Qendror i Personelit (HRMIS) dhe Platforma e Bashkëpunimit administrata.al; intensifikimin e punës lidhur me procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit dhe hartimin e një raporti të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2023. **Këto detyra janë realizuar plotësisht** nga Komisioneri, ashtu si është evidentuar edhe në raportin vjetor, që është paraqitur pranë Kuvendit.

Ndërkohë, Komisioneri është duke vijuar veprimtarinë e tij gjatë vitit kalendarik në vijim dhe krahas kontrollit të administrimit të shërbimit civil nëpërmjet mbikëqyrjeve të planifikuara, e ka

orientuar punën edhe drejt këshillimit dhe ndihmës së institucioneve për të zbatuar drejt ligjin, në të gjitha institutet e tij, si një përvojë tashmë e krijuar, e cila do të realizohet nëpërmjet asistencës teknike përmes stafit të tij, drejtuar tek njësitë përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që do të shfaqin nevojë në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh rrethanat e pasqyruara në raportin e Komisionerit, në lidhje me nivelin e ulët të trajnimit të nëpunësve të njësive të administrimit të burimeve njerëzore në bashki, në drejtim të popullimit me të dhëna të Regjistrat Qendror të Personelit (*HRMIS*) dhe të Platformës së bashkëpunimit *administrata.al*, Komisioneri po bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me qëllim që *të merren masa për të organizuar trajnime me këtë tematikë*, për të rritur kapacitetet e burimeve njerëzore në fushën teorike dhe në aspektin praktik, me qëllim që të kuptojnë drejt procesin dhe të zbatojnë me saktësi nivelet e tij.

Po kështu, vijon puna në drejtim të evidentimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfites, me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të tyre, e cila gjatë këtij viti është përqendruar në administratën shtetërore, për të konstatuar progresin që është arritur në këtë aspekt të zbatimit të ligjit.

Duke vlerësuar se i kemi parashtruar në mënyrë të përmbledhur përpara Kuvendit, punët e kryera nga Komisioneri për vitin 2023 dhe me besimin se duke punuar së bashku kemi arritur që të ndikojmë në përmirësimin e standardeve mbi të cilat organizohet dhe vepron shërbimi civil, si një shtyllë e rëndësishme e administratës publike në vendin tonë, dëshiroj të rikonfirmoj edhe një herë gatishmërinë e institucionit të Komisionerit, për të bërë më të mirën në misionin që i është ngarkuar.

Duke Ju falënderuar paraprakisht për mirëkuptimin,

Me respekt

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**